REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERZIAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese Izlazne: Date / Dana. 07 / 05 / 2025
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 108 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 3
Ferizaj - Uroševac

## Kalendari i Takimeve Publike për Buxhetimin me Pjesëmarrje

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, në koordinim me drejtorët e drejtorive komunale, Njësinë për Komunikim me Publikun dhe zyrtarë të tjerë komunalë, publikon kalendarin për organizimin e takimeve publike me qytetarë, në kuadër të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.

### Kalendari i Takimeve Publike për Buxhetimin me Pjesëmarrje në Komunën e Ferizajt

Në takimin e parë qytetarët paraqesin propozimet e tyre për projekte, ndërsa në takimin e dytë zhvillohet votimi për projektet e përzgjedhura. Projekti që merr më së shumti vota nga qytetarët, kalon në fazën e përfshirjes në buxhetin e vitit 2026.

# *- Procesverbal -*

Më datë 22.04.2025, në kuadër të takimeve publike për buxhetimin me pjesëmarrje, është mbajtur takimi me banorët e fshatit Prelez i Jerlive.

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

Në këtë takim morën pjesë:

- Meriton Hajdini, Drejtor i Infrastrukturës
- Shyhrete Topalli, Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun
- Ganimete Shehaj, Kryesuese e Komisionit për Buxhetim me Pjesëmarrje
- Xhelal Topalli, Anëtar i Komisionit

Në hapje të takimit, drejtori Hajdini theksoi se ky është viti i dytë që organizohet buxhetimi me pjesëmarrje në Komunën e Ferizajt. Ai njoftoi se për këto projekte është ndarë 1% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale.

"Për fshatin Prelez i Jerlive janë paraparë rreth 35,000 euro, dhe ju mund të propozoni projekte që përafrohen me këtë shumë," – deklaroi drejtori Hajdini.

Propozimet e banorëve:

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

1. Ekrem Sadiku – Propozoi rregullimin e kanalit të ujit që kalon përmes fshatit.
2. Mehmet Mustafa – Propozoi ndërtimin e një fushe sportive dhe një parku pranë xhamisë së re.
3. Qerim Osmani – Propozoi pastrimin e fushës sportive aktuale.
4. Besim Haliti – Propozoi:
    - Riparimin e shkollës paralele "Ismail Qemajli",
    - Vendosjen e shportave në rrugët kryesore të fshatit,
    - Vendosjen e disa ulëseve (pushimoreve).
5. 
6. Idriz Fazliu – Propozoi renovimin e tavanit të shkollës.
7. Skender Azemi – Propozoi ndërtimin e një kabineti për shkollën.

Takimi përfundoi me këto propozime, të cilat do të votohen nga banorët më 28.04.2025.

Takimi është mbyllur në orën 18:00.

Procesmbajtës:

Xhelal Topalli